

Kallas: Moment i ri për dialogun, jam
gati të organizoj takim të nivelit të lartë



Faqe 2

U premtuan 160 çerdhe
e u hapën 29



Faqe 3

SHBA-ja godet ishullin
strategjik iranian



Faqe 4

Liria dhe
arsyeja – kur
iluminizmi s’ merr
fund kurrë

Faqe 7-14



e diel • 15 mars 2026

Numri 10302

KOHA DITORE

www.koha.net



KOSOVA SPRAPSET NGA ZOTIMI PËR TA ZBATUAR STRIKT LIGJIN PËR TË HUAJT DHE ATË PËR AUTOMJETE

Kurti lëshon pe për ilegalët

Qeveria është pajtuar që, duke nisur nga e diela, zbatimi i Ligjit për të huajt dhe i atij për automjete të fillojë me lehtësira për serbët që punojnë në institucione paralele apo që studiojnë në universitetin në veri. Me kërkesë të Bashkimit Evropian, i cili për këtë çështje e dërgoi në Kosovë emisarin e posaçëm për dialogun, Peter Sorensen, Kosova u pajtua që t’u lëshojë leje qëndrimi 12-mujore studentëve serbë që nuk kanë dokumente të Kosovës dhe t’i pranojë dokumentet e identifikimit të lëshuara edhe nga strukturat ilegale, edhe për tre muaj. Vendimi nxiti reagimin e opozitës, por u mirëprit nga ambasadorë të akredituar në Kosovë

Marigona Brahimi

PRISHTINË, 14 MARS – Një ditë para fillimit të zbatimit të Ligjit për të huajt, si dhe të atij për automjete, Bashkimi Evropian (BE) e ka dërguar në Prishtinë përfaqësuesin e posaçëm për dialogun Kosovë-Serbi, Peter Sorensen, e i cili nuk është kthyer në Bruksel duarthatë.

Në takimin që në mëngjesin e së shtunës pati me kryeministrin Albin Kurti, ai shprehu kërkesë që implementimi i dy ligjeve të mos jetë i menjëhershëm por gradual, dhe të mos i ndërpresë shërbimet shëndetësore e arsimore për serbët lokalë. Këto shërbime merren në institucione ilegale që Serbia i mban në Kosovë.

Pas takimit me Kurtin dhe me shefin e zyrës së BE-së në Prishtinë, Aivo Orav, Sorensen kërkoi lehtësira për serbët.

“E konsiderojmë prioritet kyç që Qeveria e Kosovës t’u sigurojë leje qëndrimi punëtorëve dhe studentëve të përfshirë për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, në mënyrë që të parandalohet çdo ndërprerje e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore. Për të siguruar mosndërprerjen e shërbimeve, i kërkuam Kosovës të lejojë përdorimin e letërnjoftimeve të lëshuara jo më vonë se 15 mars 2026 nga Serbia për ata që jetojnë në Kosovë, si mjet identifikimi për proceset administra-

tive”, ka thënë Sorensen, në konferencën e përbashkët të shtypit me kryeministrin Kurti dhe ambasadorin Orav.

Ligji për të huajt parasheh që të gjithë personat që nuk posedojnë dokumente të Kosovës të pajisen me leje qëndrimi, ndërsa automjetet me targa të huaja nuk do të mund të qarkullojnë në Kosovë për më shumë se tre muaj, përveç nëse kanë autorizim përkatës.

Megjithatë, pas takimit të së shtunës është vendosur që këto rregulla të mos zbatohen menjëherë për serbët e Kosovës pa dokumente kosovare. Ata do të kenë mundësi të pajisen me leje të përkohshme qëndrimi deri në 12 muaj, si dhe të përdorin si dokument identifikimi letërnjoftimet e lëshuara nga struktura paralele në vend.

I pari që e kumtoi këtë është Orav. “Diskutuam për zbatimin, i cili do të fillojë nesër. Kemi pasur bisedime intensive me Qeverinë e Kosovës gjatë javëve të fundit. Dhe sot ka marrëveshje për zbatimin e ligjit për të huajt me hapa thelbësorë shtesë, para së gjithash sa i përket procesit të regjistrimit të serbëve të Kosovës dhe lejes së përkohshme të qëndrimit”, ka thënë ai.

Kryeministri Kurti dha detaje për lëshimet e bëra, e të cilave iu referua si “lehtësira”.

vijon në faqen e dytë



Prishtinë, 14 mars – Qeveria ka nisur ta shkruajë programin për katër vjetët e ardhshëm, ka njoftuar të shtunën kryeministri Albin Kurti. Ai ka bërë të ditur se për dy ditë rresht do të zgjasë takimi i kabinetit qeveritar, me qëllim që zotimet e fushatës para qytetarëve dhe ekspozëja e prezantuar para deputetëve të shndërrohet në program qeverisës. Kurti është zotuar se angazhimi, e mira e përgjithshme dhe interesi publik, zhvillimi dhe barazia, integriteti dhe dinjiteti shtetëror do të mbeten pikënisja dhe synimi i qeverisjes

MBETET I BLOKUAR AKTIVITETI I PROKURIMIT NË VLERË 7.6 MILIONË EURO

Tenderi milionësh për proteza lë pa disa materiale Ortopedinë

Vlerë Mehmeti

PRISHTINË, 14 MARS – Tenderi i SHSKUK-së në vlerë prej 7.6 milionë eurosh për furnizim me material medicinal për Ortopedi, që synonte vendosjen e protezave edhe nëpër spitale rajonale, ka lënë pa disa materiale edhe Klinikën e Ortopedisë në QKUK.

Tenderi, i hapur më 11 nëntor të vitit 2025, aktualisht ndodhet i bllokuar në OSHP, pas ankimit për herë të dytë radhazi. Në vendimin e parë, më 10 shkurt, OSHP-ja kishte kërkuar nga SHSKUK-ja të përmirësojë dosjen e tenderit, pasi kishte konstatuar se kriteret dhe specifikat teknike nuk ishin të harmonizuara me Listën esenciale. Megjithatë, lënda u ankimua përsëri nga e njëjta kompani në fillim të muajit mars, me

pretendimin se korrigjimet e kërkuara në LOT-in 1 dhe LOT-in 3 nuk ishin bërë dhe se SHSKUK-ja kishte vendosur sërish kritere favorizuese.

Paneli shqyrtues i OSHP-së kishte konstatuar se SHSKUK-ja, në disa raste, kishte vendosur kufizime duke kërkuar madhësi strikte, e në disa raste nuk kishte specifikuar fare madhësitë, duke diskriminuar dhe kufizuar konkurrencën. Pretendimet për mospërmirësim të dosjes së tenderit kanë lënë hapësirë që operatorët ekonomikë të ankohen sërish në marsin e këtij viti. E vetë SHSKUK-ja kur hapi tenderin në nëntor të vitit 2025, kishte kërkuar përsheptim të procedurave, duke theksuar urgjencën për mbylljen sa më të shpejtë me kontratë të këtij aktiviteti të prokurimit.

Në dosje theksohej se pacientët po

detyrohen t’i blejnë vetë materialet e nevojshme, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e listës së pritjes.

“Duke marrë parasysh se në përbërje të kësaj kërkesë përfshihen materialet nga trauma ortopedike dhe spinale, si dhe proteza, kërkojmë që procedurat përkatëse të përshejtohen. Kjo kërkesë bëhet për shkak të mungesës aktuale të këtyre materialeve, e cila po ndikon drejtpërdrejt në trajtimin e pacientëve – shumë prej tyre po detyrohen t’i blejnë vetë materialet e nevojshme. Gjithashtu mungesa e protezave po pengon realizimin e operacioneve të planifikuara, duke shkaktuar rritje të listës së pritjes”, thuhet në dosje.

Në Klinikën e Ortopedisë konfirmuan se për shkak të bllokimit të tenderit për blerjet e reja, aktualisht ka mungesa të disa llojeve të protezave të kërdhokullës dhe gjurit.

“Lidhur me blerjen e materialeve nga pacientët institucioni është duke punuar që trajtimi i pacientëve të realizohet në kuadër të furnizimeve institucionale dhe të minimizohet nevojja që pacientët të sigurojnë vetë materialet”, ka thënë Xhavit Gashi, drejtor i Klinikës së Ortopedisë.

E në përgjigjen që ka dhënë zyra e prokurimit e SHSKUK-së thuhet se institucioni ka respektuar vendimin e OSHP-së duke bërë ndryshimet dhe korrigjimet e kërkuara.

Klinika e Ortopedisë është ndër ato me numrin më të madh të pacientëve në pritje për vendosje të protezave të gjurit dhe të kërdhokullës.

Në listën e pritjes figurojnë pacientë që nga viti 2020.

© KOHA Ditore

Shaqiri tregon se e kishte
shqyrtuar seriozisht
paraqitjen për Kosovën



Xherdan Shaqiri e kishte pasur mundësinë që të luante për Kosovën shumë kohë më parë. Madje e kishte shqyrtuar seriozisht mundësinë për t’u paraqitur për Kosovën. Kishte pasur edhe shumë biseda për një gjë të tillë. Por ai mbeti te Zvicra dhe u kthye në njërin prej lojtarëve më të mirë...

Faqe 14